


Produkti i Brendshëm Bruto, 2021

Vlerësime finale 2020 dhe gjysmë-finale 2021

Tiranë, më 30 Mars 2023: Në vitin 2021, Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) shënoi një rritje në terma realë (në volum) prej 8,91 %, krahasuar me vitin 2020, pas një rritje prej -3,30 % në vitin 2020, krahasuar me vitin 2019.

Fig 1. PBB dhe rritja ekonomike, 2017 – 2021*



PBB me çmime korrente u vlerësua 1,856,172 milion lekë (15,16 miliardë Euro) në vitin 2021 dhe 1,647,431 milion lekë (13,31 miliardë Euro) në vitin 2020. PBB për frymë në vitin 2021 arriti 660 mijë lekë (ose 5,391 €) nga 581 mijë lekë (ose 4,690 €) në vitin 2020.

Tab.1 Treguesit kryesorë makroekonomikë (2020-2021* me çmime korrente)


Treguesit	Vitet		
	2020	2021*	
Produkti i Brendshëm Bruto me çmime korrente (në milion lekë)	1.647.431	1.856.172	
Të ardhurat kombëtare bruto (në milion lekë)	1.620.074	1.830.192	
Rritja reale vjetore e PBB me çmime konstante krahasuar me vitin e mëparshëm (në %)	-3,30	8,91	
Deflatori i PBB (në %)	0,70	3,45	
Popullsia mesatare vjetore (në mijë banorë)	2.838	2.812	
Produkti i Brendshëm Bruto për frymë	Mijë lekë	581	660
	EURO	4.690	5.391
	USD	5.343	6.377

2021* Të dhëna gjysmë-finale

Sipas PBB-së me metodën e prodhimit, kontributin kryesor në këtë rritje e kanë dhënë aktivitetet e ekonomisë si: “Tregtia, transporti, akomodimi dhe shërbimi ushqimor” me +1,64 pikë përqindje; “Ndërtimi” me +1,61 pikë përqindje; “Industria gjithsej” me +1,17 pikë përqindje; “Administrata publike, arsimi dhe shëndetësia” me +0,94 pikë përqindje; “Aktivitete profesionale, administrative dhe mbështetëse” me +0,40 pikë përqindje; “Aktivitetet të pasurive të paluajtshme” me +0,35 pikë përqindje; “Bujqësia, pyjet dhe peshkim” me +0,35 pikë përqindje; “Informacioni dhe komunikacioni” me +0,30 pikë përqindje; “Aktivitetet financiare dhe të sigurimit” me +0,24 pikë përqindje; “Arte, argëtim dhe çlodhje, aktivitete të tjera shërbimi” me +0,20 pikë përqindje.

Taksat neto mbi produktet kontribuan respektivisht me 1,72 pikë përqindje.

Fig 2. Kontributi i degëve kryesore të ekonomisë në normën reale të rritjes së PBB - së 2021, në pikë përqindje



Përsa i përket strukturës së PBB-së sipas aktiviteteve ekonomike, peshën më të madhe në ekonomi për vitin 2021 vazhdojnë ta zënë *Shërbimet gjithsej* me 47,86 %, duke shënuar një rritje në terma realë me 8,41 %. *Industria dhe Ndërtimi* zënë 20,75 % të PBB-së, duke shënuar rritje në terma realë përkatësisht 10,44 % dhe 18,01 %. *Bujqësia, gjuetia, pyjet dhe peshkimi* zënë 18,36 % të PBB-së me një rritje në terma realë prej 1,80 %.

Deflatori i PBB-së për vitin 2021 është 3,45 %.

Tab.2 Treguesit sipas aktiviteve ekonomike

A10	Aktiviteti ekonomik sipas NVE Rev. 2	Vlerat me çmime korente Në Milion Lekë		Vlerat me çmime të vitit të mëparshëm	Rritja reale (%)	Struktura e PBB (%)		Kontributi
		2020	2021*	2021*	2021*	2020	2021*	2021*
A1	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	316.722	340.758	322.425	1,80	19,23	18,36	0,35
A2	Industria gjithsej	184.332	208.505	203.580	10,44	11,19	11,23	1,17
2a	nga cila: Industria përpunuese	101.416	114.251	112.713	11,14	6,16	6,16	0,69
A3	Ndërtimi	147.041	176.595	173.519	18,01	8,93	9,51	1,61
A4	Tregtia; transporti; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor	267.555	304.579	294.645	10,12	16,24	16,41	1,64
A5	Informacioni dhe komunikacioni	49.877	55.769	54.744	9,76	3,03	3,00	0,30
A6	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	34.220	38.173	38.105	11,35	2,08	2,06	0,24
A7	Aktivitete të pasurive të paluajtshme	99.749	106.052	105.560	5,83	6,05	5,71	0,35
A8	Aktivitete shkencore, profesionale , administrative dhe mbështetëse	105.243	114.117	111.876	6,30	6,39	6,15	0,40
A9	Administrata publike;Arsimi; Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale	202.262	228.143	217.769	7,67	12,28	12,29	0,94
A10	Arte, argëtim dhe çlodhje; Aktivitete të tjera shërbimi	37.589	41.590	40.809	8,57	2,28	2,24	0,20
	Vlera e Shtuar Bruto me çmime bazë	1.444.591	1.614.282	1.563.032	8,20	87,69	86,97	7,19
	Taksa neto mbi produktet	202.840	241.890	231.186	13,97	12,31	13,03	1,72
	Prodhim i Brëndshëm Bruto me çmimet e tregut	1.647.431	1.856.172	1.794.217	8,91	100,00	100,00	8,91

2020 Të dhëna Finale


2021* Të dhëna Gjysëm-finale

Sipas PBB-së me metodën e shpenzimeve, Konsumi final përbën peshën kryesore të shpenzimeve në ekonomi, me 88,56 %. Ky komponent u rrit me 7,88 % në terma nominalë dhe 5,06 % në terma realë. Konsumi final i popullatës zë 76,03% të Konsumit final i ndjekur nga Konsumi i administratës publike me 11,91 % dhe Konsumi i institucioneve jo-fitimprurëse në shërbim të familjeve (JFShF) me 0,62 %.

Në vitin 2021, Formimi bruto i kapitalit fiks i cili përbën 24,35 % të PBB-së, u rrit në terma nominalë me 21,15 % dhe në terma realë me 19,21%, krahasuar me vitin 2020.

Eksportet e mallrave dhe shërbimeve u rritën me 55,69 %, në terma nominalë dhe me 52,05 % në terma realë, ndërkohë që Importet e mallrave dhe shërbimeve u rritën me 35,52 %, në terma nominalë dhe 31,45 % në terma realë, krahasuar me vitin 2020.

Fig 3. Struktura e PBB-së me metodën e Shpenzimeve, në %



Tab.3 Treguesit e komponentëve kryesorë të Shpenzimeve

Treguesit e PBB-së	Vlerat me çmime korente		PBB me çmime të vitit të mëparshëm	Rritja reale (%)	Struktura e PBB (%)		Kontributi
	Në Milion Lek				2020	2021*	
	2020	2021*	(2021/2020)	2021*	2020	2021*	2021*
Konsumi Final	1.523.799	1.643.836	1.600.937	5,06	92,50	88,56	4,68
Konsumi Final i Popullatës	1.317.607	1.411.321	1.379.557	4,70	79,98	76,03	3,76
Konsumi Final i Administratës Publike	195.196	221.041	210.366	7,77	11,85	11,91	0,92
Konsumi Individual	90.834	104.621	101.068	11,27	5,51	5,64	0,62
Konsumi Kolektiv	103.910	116.420	109.298	5,18	6,31	6,27	0,33
Konsumi i Institucioneve Jo-fitimprurëse	10.996	11.475	11.014	0,16	0,67	0,62	0,00
Formimi Bruto i Kapitalit Fiks	373.135	452.045	444.828	19,21	22,65	24,35	4,35
Ndryshimet e gjëndjeve	5.198	8.514	8.335		0,32	0,46	
Mospërputhje statistikore	-15.590	498	-22.458		-0,95	0,03	
Eksporti neto	-239.111	-248.721	-237.426	0,70	-14,51	-13,40	0,10
Eksportet e mallrave e shërbimeve (fob)	373.271	581.152	567.559	52,05	22,66	31,31	11,79
Eksportet e mallrave	98.184	154.814	147.448	50,17	5,96	8,34	2,99
Eksportet e shërbimeve	275.087	426.337	420.111	52,72	16,70	22,97	8,80
Importet e mallrave e shërbimeve (fob)	612.382	426.337	804.984	31,45	37,17	22,97	11,69
Importet e mallrave	467.300	829.873	602.850	29,01	28,37	44,71	8,23
Importet e shërbimeve	145.082	206.707	202.134	39,32	8,81	11,14	3,46
Prodhim i Brëndshëm Bruto me çmimet e tregut	1.647.431	1.856.172	1.794.217	8,91	100,00	100,00	8,91

2020 Të dhëna Finale

2021* Të dhëna Gjysmë-finale

Metodologjia

Metodologji dhe klasifikime

Llogaritjet e PBB-së mbështeten metodologjikisht në konceptet bazë të Sistemit Europian të Llogarive (ESA 2010) dhe të Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA 2008) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Të dyja këto metodologji janë përditësimet më të fundit të ESA 1995 dhe SNA 1993. Sistemi evropian i llogarive kombëtare dhe rajonale është korniza për matjen e aktiviteteve ekonomike dhe financiare të një sistemi ekonomik, komponentëve të tij dhe lidhjeve midis tyre në një periudhë kohe të dhënë (zakonisht një vit ose një tre-mujor). Transaksionet e kryera nga agjentët ekonomikë në lidhjet e tyre me njësitë e tjera rezidente ose jo rezidente në territorin ekonomik janë objekt i matjeve në llogaritë kombëtare.

Klasifikimet e përdorura në Llogaritë Kombëtare janë:

- Nomeklatura e veprimtarive ekonomike REV .2 (NVE Rev .2);
- Nomeklatura e produkteve (NP);
- Klasifikimi i konsumit individual sipas përdorimit (COICOP);
- Klasifikimi i shpenzimeve të qeverisë sipas funksionit (COFOG).

Burimet e të dhënave

Për vlerësimet e PBB-së përdoret informacioni i siguruar nga burime të ndryshme statistikore dhe administrative. Të dhënat e përdorura mund të jenë prodhim statistikor i vetë INSTAT-it ose i institucioneve të ndryshme kombëtare si Ministrinë, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave, Qendra Kombëtare e Biznesit, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe të tjera. Duke krahasuar këto burime me njëra-tjetrën, arrihet të prodhohet një pamje e vetme e ekonomisë e cila është gjithëpërfshirëse, konsistente, koherente dhe tërësisht e integruar.

Burimet statistikore përfshijnë të dhënat e siguruar nga regjistrime dhe anketa të ndryshme mbi njësitë ekonomike ose familjet ndër të cilat mund të përmendim: Regjistri i Ndërmarrjeve, Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave, Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve, Anketa e Tregtisë me Pakicë, Anketa e Buxhetit të Familjeve, Anketa e Forcave të Punës, Anketa të Statistikave të Çmimeve, etj.

Burimet administrative përfshijnë të dhëna administrative të mbledhura nga institucione të tjera për qëllime të ndryshme, ndër të cilat mund të përmendim: Pasqyrat financiare vjetore, Tatimi mbi vlerën e

shtuar (TVSH), Statistika financiare monetare, Bilanci i Pagesave, Statistika fiskale të qeverisë, Statistika të tregtisë së jashtme, Të dhëna mbi energjinë elektrike dhe të produkteve energjitike, etj.

Fazat e publikimit dhe Politikat revizionuese

Vlerësimet e PBB-së vjetore kalojnë në dy faza llogaritjesh dhe publikimesh.

- Faza e parë përfshin vlerësimet gjysëm-finale të llogarive vjetore të PBB të vitit "t", të cilat kryhen në periudhën t+15 muaj.
- Faza e dytë përfshin vlerësimet finale të PBB të vitit (t). Në këtë fazë rishikohen dhe njëherë të dhënat e vitit (t) kur vjen seti i të dhënave për vitin (t+1) me qëllim që të përfshihet çdo ndryshim i bërë për vitin (t) dhe të sigurohet konsistenca midis dy viteve të njëpasnjëshëm. Gjatë kësaj faze bëhet dhe balancimi final në nivel produkti midis dy metodave të PBB-së.

Të dhënat e publikuara revizionohen mbështetur në politikat revizionuese të llogarive kombëtare. Vlerësimet vjetore të Produktit të Brendshëm Bruto dhe komponentëve të tij janë subjekt i dy tipeve të revizionimit: të zakonshme dhe të veçanta.

Revizionime të zakonshme:

Revizionimet e zakonshme të PBB-së me baza vjetore janë rezultat i përditësimeve dhe plotësimit të burimeve ekzistuese të të dhënave me informacionin më të fundit për një vit të caktuar "t".

Revizionime të veçanta:

Revizionimet e veçanta vijnë si rezultat i përfshirjes së burimeve të reja të të dhënave statistikore e administrative dhe përmirësimi i atyre ekzistuese, përmirësimi të teknikave statistikore dhe metodave të përpilimit të të dhënave për Llogaritë Kombëtare, ndryshimit të metodologjisë për shkak të standarteve të reja të Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA dhe ESA).

Përkufizime

Produkti i Brendshëm Bruto (PBB): Produkti i brendshëm bruto, vlerësuar me çmimet e tregut, është rezultati final i aktivitetit të prodhimit nga njësitë rezidente prodhuese gjatë një viti . Ai është llogaritur sipas dy mënyrave:

- **PBB me mënyrën e prodhimit**, është i barabartë me shumën e vlerave të shtuara bruto sipas degëve të ndryshme të aktivitetëve, duke shtuar tatimet e taksat e duke i zbritur subvencionet mbi produktet (të cilat nuk u janë shpërndarë sektorëve apo degëve të aktivitetit);

- **PBB sipas mënyrës së shpenzimeve** është i barabartë me përdorimet finale të brendshme të produkteve e shërbimeve (konsumi final efektiv, formimi bruto i kapitalit fikse, ndryshimet e gjendjeve), plus eksportet, minus importet.

Prodhimi: Aktivitet i ushtruar nën kontrollin dhe përgjegjësinë e një njësie institucionale që kombinon burimet e fuqisë punëtore, kapitalit dhe produkteve e shërbimeve për të prodhuar produkte ose kryer shërbime. Proçeset e pastra natyrore pa ndërhyrjen ose kontrollin e njeriut nuk bëjnë pjesë në prodhim. Ekzistojnë tre lloje të prodhimit: prodhim tregu, prodhim i prodhuar për konsum final vetjak dhe prodhim tjetër jo-tregu.

Konsumi i ndërmjetëm: Vlera e produkteve ose shërbimeve të transformuara ose plotësisht të konsumuara gjatë procesit të prodhimit. Përdorimi i aktiveve fikse të vëna në punë nuk merret parasysh. Ai evidentohet në konsumin e kapitalit fikse.

Vlera e shtuar bruto: Vlera e shtuar bruto përfaqëson kontributin e aktiviteteve të ndryshme në PBB dhe llogaritet si diferencë midis prodhimit dhe konsumit të ndërmjetëm.

PBB -ja nominale mat vlerën e produkteve për një periudhë të caktuar kohore, me çmimet e periudhës në të cilin prodhohet produkti (çmimet e tanishme).

PBB - ja reale mat produktin gjithsej të prodhuar në një ekonomi, për një periudhë të caktuar kohore, duke marrë parasysh çmimet e një viti bazë (i cili është viti paraardhës ose një vit që caktohet si vit bazë).

Taksat mbi produktet dhe importin: Taksat mbi produkte janë taksat e pagueshme për njësi të mallrave dhe shërbimeve si Taksa mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), akciza, taksa doganore mbi importet dhe taksa të tjera.

Subvencione në produkte: Subvencionet në produkte janë pagesat e pakthyeshme që njësitë e administratës publike bëjnë tek ndërmarrjet si një shumë e caktuar parash për njësi të një malli ose shërbimi. Subvencionet në importe konsistojnë në subvencionimin e mallrave ose shërbimeve që bëhen të pagueshme kur malli kapërcen kufirin e territorit ekonomik ose kur shërbimet i janë kaluar njësite institucionale rezidente.

Konsumi Final: Konsumi Final është një nga komponentët kryesorë të PBB-së. Ky konsiston në mallrat dhe shërbimet e përdorura nga familjet individuale ose komunitetet dhe llogaritet si shumë e konsumit final të familjeve, konsumit final të administratës publike dhe konsumit final të Institucioneve Jo-Fitimprurëse në Shërbim të Familjeve (IJFSHF).

Konsumi final i familjeve: Llogarit të gjitha mallrat dhe shërbimet që përdoren direkt për të plotësuar kërkesat individuale të familjeve rezidente.

Konsumi final i administratës publike dhe Institucioneve jo fitim prurëse: Përmban vlerën e shërbimeve jotregtare të kryera nga administrata publike dhe nga institucionet jofitimprurëse në përfitim të komuniteteve ose grupe familjesh. Kjo llogaritet si diferencë midis prodhimit të administratës publike dhe IJFSHF dhe vlerës së prodhimit tregtar.

Eksporti neto: Eksporti neto llogaritet si diferencë midis eksportit të mallrave dhe shërbimeve (f.o.b) dhe importit të mallrave dhe shërbimeve (f.o.b).

Formimi Bruto i Kapitalit Fiks: Konsiston në shpenzimet e kryera për kapitale të reja ose për shpenzime të tjera specifike kryer nga prodhuesit në sende ose shërbime me qëllim që të mbajnë, rritin ose zgjerojnë kapacitetin e tyre prodhues ose që të krijojnë kushte të reja përpunimi në të ardhmen.

Ndryshimi i gjendjeve: Përcaktohet si diferencë midis gjendjeve të inventarit dhe në proces të aktiveve qarkulluese në fund dhe në fillim të vitit. Gjendjet përfshijnë: materiale të para dhe materiale të tjera, prodhime, punime shërbime në proces, produkte të gatshme e gjysëm të gatshme, mallra, kafshë, etj.

Çmimi bazë: Shuma që prodhuesi merr nga blerësi për njësi të produktit apo shërbimit të prodhuar, pa tatimet dhe subvencionet mbi produktin. Çmimi bazë përjashton shpenzimet e transportit të faturuara më vete.

Çmimet e tregut: janë çmimet pasi shtohen taksat mbi produktet minus subvencionet mbi produktet.

Çmime korente: Janë çmimet e periudhës referuese. Ato përfaqësojnë çmimin e paguar për të mirat dhe shërbimet në kohën e prodhimit ose të konsumit.

Çmime konstante: Vlerësimet me çmime konstante janë në vlerë reale, pra të korrigjuara për ndryshimet në çmime në lidhje me një vit bazë. Ato janë një mënyrë për të matur ndryshimin real në prodhim.